

DOKUMENTI I SHKURTËR PËR POLITIKA PUBLIKE NR.14/2021

MËSIMI PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT FUNKSIONON, NGEL VETËM ARSIMI

MISHA POPOVIO



Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit "Edukimi anti-korrupsion për nxënësit e shkollave të mesme" me ndihmë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, zbatuar nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" Shkup së bashku me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Impresum

Titull: Mësimi për luftën kundër korrupsionit funksionon, ngel vetëm arsimi

Autori: Misha Popoviq

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Përkthimi: Vjosa Taipi

Dizajni: Matea Londza Shumkovska

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.idscs.org.mk>

Në fund të vitit 2020, më shumë se 600 nxënës në tetë shkollat të mesme në Maqedoninë e Veriut kaluan të paktën dy orë arsimit edukim në temën korrupsion.¹ Këto orë mësimore u realizuan duke përdorur mjetet mësimore të zhvilluara në kuadër të projektit "Edukimi Antikorrupsion në Shkollat e Mesme në Maqedoninë e Veriut", zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit, e ndihmuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës.² Orëve paraprinë përgatitje të materialeve dhe trajnimi i 13 mësuesve që realizuan orët mësimore.^{3,4} Qëllimi ishte të transferojnë njohuri dhe aftësi në mënyrë që nxënësit të identifikojnë korrupsionin, si dhe ku është më mirë të denoncojnë korrupsionin. Pika fillestare për këtë iniciativë ishin rezultatet e hulumtimit të madh të opinionit publik, ku gjenerata më e re (18-29 vjeç) një periudhë kohore të caktuar ka pasur rezultat krahasues më të keq në identifikimin dhe pranimin e korrupsionit. Për këtë qëllim, janë hulumtuar mënyra se si të intervenohet në arsim, për të përmirësuar rezultatet e brezave të ardhshëm. Qëllimi shoqëror është krijimi i brezave që nuk tolerojnë korrupsionin, dinë ku ta raportojnë dhe janë të gatshëm të përfshihen në luftë.

Për të testuar suksesin e procesit arsimor, ne përgatitëm një pyetësor që nxënësit iu përgjigjën

dy herë. Herën e parë ata iu përgjigjën para orëve dhe vala e dytë është disa ditë pas mbajtjes së orës së fundit. Periudha e realizimit të mësimin ishte midis tetorit dhe dhjetorit 2020. Një kufizim i rëndësishëm i të gjithë procesit ishte sigurisht online mësimi i cili nuk është mënyra optimale për të pilotuar një program mësimor dhe kufizon punën në grupe në orë. Për më tepër, për vetë matjen e suksesit u shpërnda pyetësor në internet, kështu që pjesëmarrja në testime mund të ishte vetëm vullnetare. Në fund, 347 nxënës morën pjesë në testin e parë dhe 287 nxënës në testin e dytë. Shkalla e përgjigjes në raport me gjithë popullsinë është e kënaqshme ndërsa madhësia e të dy mostrave është më se e mjaftueshme për të kryer analiza statistikore.

Përgjigjet e pyetjeve analizohen në grupe dhe individualisht, por për sa i përket rezultateve, ato grupohen në katër grupe: njohja e korrupsionit, njohja se ku është e përshtatshme të raportohet, njohja e elementeve të përkufizimit dhe qëndrimet e lidhura me vlerën në lidhje me korrupsionin. Në mënyrë që të barazohen rezultatet në të njëjtën shkallë për të katër elementët, u përdor një renditje në përqindjen e të gjitha përgjigjeve, të cilat më pas krahasohen të ndarë në dy valë për të vlerësuar suksesin e mjeteve mësimore dhe procesin e transferimit të njohurive.

¹ Më shumë informacion në lidhje me pilot programin në: <https://bit.ly/3nqfxJF>. Tetë shkollat e mesme janë:

1. SHMMQSH „Dr. Pançe Karagjozov” - Shkup
2. SHMK "Slavčo Stojmenski" - Shtip
3. SHMK "Gostivar" - Gostivar
4. SHMK "Niko Nestor" - Strugë
5. SHMK "Josip Broz - Tito" - Manastir
6. SHMK "Zef Lush Marku" - Shkup
7. SHMK "8 Shtatori" - Tetovë
8. SHMK "Nikolla Karev" - Shkup

² Më shumë informacion në faqen e internetit: <https://bit.ly/3dUJ7UP>

³ Manualët mund të gjenden në: <https://bit.ly/3sUIGiB>

⁴ Më shumë informacion mbi trajnimin e mësuesve mund të gjenden në: <https://bit.ly/3gCilCi>

Njohja e korrupsionit



Njohja e korrupsionit është baza për ndërtimin e qytetarëve të cilët do të jenë në gjendje të dinë në të ardhmen kur janë viktime ose dëshmitarë të korrupsionit. Kjo krijon mundësinë që ata të marrin pjesë më tej në luftën kundër korrupsionit.

Nxënësve u paraqiten disa situata dhe nga secili kërkohet të thotë nëse paraqesin apo jo korrupsion. Të gjitha situatat kanë elementë të rëndësishëm

të korrupsionit dhe konfliktit të interesit, kështu që renditja bëhet në përputhje me numrin e situatave të identifikuar.

Analiza tregon një ndryshim të rëndësishëm statistikor midis rezultateve të dy valëve të kërkimit - para-pilot dhe pas-pilot mësimit. Kështu, ndërsa mesatarja e nxënësve nuk arriti të kapërcejë kufirin e 50% të rezultatit më të mirë të arritur, pas mësimit është 54,4.

Tabela 1: Njohja e korrupsionit - renditja krahasuese e rezultateve

	Rezultati mesatar	Devijimi standard
Para orëve mësimore	46,5	28,1
Pas orëve të mësimit	54,4	28,5

Me t- test në mostra të pavarura është përcaktuar dallim i rëndësishëm statistikor

Përmbledhja e hollësishme konfirmon imazhin e përgjithshëm, por siguron këqyrje më të mirë të disa dobësive që duhen përmirësuar në të ardhmen. Kështu, përmirësimi i njohjes së konfliktit të interesit duhet të përmirësohet, me më shumë punë dhe


shembuj në orën mësimore. Një sukses i dukshëm shihet në njohjen e praktikës tipike në arsim kur nota lidhet me blerjen e një libri shkollor nga një profesor, që paraqet përgatitje të shkëlqyeshme për periudhën e arsimit të lartë.

⁵ Këto janë përgjigjet e pyetjeve:

A) Të jesh drejtor i një ndërmarrje komunale dhe në të njëjtën kohë të kesh kompani që jep me qira kamionët e tyre
B) Marrja e orëve private te profesor që ju mëson lëndën në shkollë

Grafik 1: Analizë e hollësishme e përgjigjeve për identifikimin e korrupsionit

Për secilën nga këto situata, thoni nëse janë apo jo korrupsion
(paraqiten vetëm përgjigjet "po")%



Shkurtimisht, mësimi dhe materialet mësimore në pilot programin e kanë arritur qëllimin e tyre dhe hapësira për identifikimin e korrupsionit është

përmirësuar. Me rritjen e vëllimit të punës, pritet që rezultatet të përmirësohen dhe të arrijnë nivelet e dëshiruara të identifikimit, në mbi 90% të rasteve.

Përcaktimi i korrupsionit



Një ndihmë e rëndësishme në identifikimin e korrupsionit është përkufizimi i vetë të anketuarve. Duke u nisur nga përkufizimi themelor i korrupsionit, i cili është keqpërdorim i detyrës së besuar për përfitime materiale ose jo-materiale, njohja e korrupsionit do të varet gjithashtu nga mundësia e braktisjes së nocionit të zakonshëm të korrupsionit përmes ryshfetit. Prandaj, i pyetëm nxënësit në lidhje me situata të shumta që operacionalizojnë elementet e interesit, ndikimit dhe ryshfetit.

Për secilën nga situatat nxënësit u përgjigjën në një

shkallë prej tre pikë nga e pasaktë, pjesërisht e saktë dhe plotësisht e saktë. Rezultati i përgjithshëm është vlera mesatare e përgjigjeve me disa përgjigje të konsideruara në drejtim të kundërt sepse ato nuk përmbajnë elemente absolutisht të nevojshme të korrupsionit.⁶

Analiza tregoi se pas mësimdhënies, rezultati mesatar i renditjes së përqindjes së përgjigjeve u rrit nga 47,5 në 53,2, me çka mund të argumentohet se materialet dhe mësuesit arritën të përmirësonin kuptimin e korrupsionit.

Tabela 2: Identifikimi i elementeve operacionale të përkufizimit të korrupsionit

	Rezultati mesatar	Devijimi standard
Para orëve mësimore	47,5	27,8
Pas orëve të mësimit	53,2	29,1

Me t- test në mostra të pavarura është përcaktuar dallim i rëndësishëm statistikor

Përmirësimi më i madh është parë në elementet që lidhen me shkëmbimin e parave, por inkurajon një përmirësim modest në rezultatin e besimit se korrupsioni nuk është gjithmonë i lidhur me paratë, politikanë të zgjedhur ose dëm të dukshëm drejtpërdrejt. Kjo prirje duhet të përmirësohet


përmes rritjes së ndërveprimit dhe trajnimit të mësuesve, përkatësisht përqendrimit në këto elemente. Kjo do të ndihmojë të përmirësohet kuptimi i korrupsionit në jetën e përditshme dhe me këtë të përgatiten brezat e ardhshëm për atë që do të ndodhë më tutje

⁶ Këto janë pyetjet:

- A) Që të ketë korrupsion, duhet të ketë shkëmbim parash
- B) Në mënyrë që të ndodhë korrupsioni, duhet të përfshihet një politikan/e i/ e zgjedhur
- C) Që të ketë korrupsion, dëmi ndaj dikujt tjetër duhet të jetë direkt i dukshëm

Grafiku 2 Identifikimi i elementeve operacionale të përkufizimit të korrupsionit

Identifikimi i elementeve operacionale të përkufizimit të korrupsionit



Raportimi i korrupsionit



Dimensioni i tretë i hulumtimit ishin institucionet, përkatësisht vendet ku duhet raportuar korrupsioni. U kërkuan të anketuarve të shënonin të gjitha institucionet përkatësisht aktorët ku ata do të raportnin korrupsionin. Rezultati individual është përmirësuar për secilën nga vendet e zgjedhura, përveç opsioneve që sugjerojnë se raportimi shihet më shumë si një anekdotë sesa raportim i ndonjë rasti. Më konkretisht të përjashtuara nga pikëzimi

janë situatat në të cilat raportohet rasti te miqtë ose në rrjetet sociale (tiktok).

Analiza në këtë rast gjithashtu gjeti një përmirësim të rëndësishëm statistikor, përkatësisht nga niveli mesatar i përqindjes prej 46,6 pas mësimit ngrihet mbi 50, përkatësisht nota mesatare është 54,3. Kjo do të thotë që mësimi ka përmirësuar njohuritë se ku duhet raportuar korrupsioni

Tabela 3: Identifikimi i vendeve për raportimin e korrupsionit

	Rezultati mesatar	Devijimi standard
Para orëve mësimore	46,6	26,6
Pas orëve të mësimit	54,3	26,4


Me t- test në mostra të pavarura është përcaktuar dallim i rëndësishëm statistikor

Analiza shtesë tregon përmirësime të dukshme në favor të raportimit institucional. Kështu, pas orëve të mësimit, nxënësit janë më të njohur me nevojën për të raportuar në institucionet shtetërore dhe sektorin

joqeveritar. Zvogëlimi i opsionit të raportimit te prindërit është gjithashtu një tregues inkurajues i pavarësisë dhe zhvendosja e barrës së menaxhimit individual me korrupsionin mbi institucionet

Grafiku3: Njohuri se ku të raportohet korrupsioni

Nëse keni qenë dëshmitar i korrupsionit, ku do ta raportoniit?




Vlerat

Së fundmi, hulumtuam disa vlera themelore shoqërore që tregojnë një prirje për konformizëm, bindje ndaj ligjit, ose preferencë për rregulla dhe tradita joformale. Konformizmi dhe preferencat ndaj rregullave dhe traditave informale janë një fortesë e vlerave që mundëson tolerancën e korrupsionit. Për shembull, të biesh dakord se traditat janë më të rëndësishme se ligjet, ose se shërbimi kthehet me kundër shërbim, janë vlera që kontribuojnë në sjelljen informale. Për shtatë pikëpamje të tilla, nxënësit

kishin mundësi të deklarohen se në çfarë mase ishin dakord. Vlera mesatare e të gjitha deklaratave renditet më tej si përqindje e të gjithë të anketuarve.

Ndryshe nga dimensionet e mëparshme, pilot programi i shkurtër dështoi të ndryshojë ndjeshëm këto vlera. Kështu, në valën e parë rezultati ishte 49,7 dhe pas mësimit 50,5. Analiza e hollësishme gjithashtu nuk tregon ndonjë devijim specifik nga përfundimi i përgjithshëm.

Grafiku 4: Orientimet e vlerës në lidhje me korrupsionin



Rezultatet në këtë dimension janë të pritshme sepse procesi i ndryshimit të vlerave nuk mund të varet nga një pilot program me disa orë shkollore. Hulumtimi

përfshiu këtë dimension si kontroll në mënyrë që tendencat e trendeve të mund të kontrollohen, përmes një procesi të kontroleve, zhvendosjes së trendeve.

Përmbledhje dhe përfundim

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se mjetet mësimore janë mjet i përshtatshëm për transferimin e njohurive në lidhje me problemin e korrupsionit në vend, dhe procesi i mësimdhënies dhe mësuesit arritën të rrisin nivelin e njohurive të nxënësve. Nëse për korrupsionin flitet hapur në klasë dhe udhëhiqet nga një mënyrë sistematike e transferimit të njohurive, do të arrihen rezultate në identifikimin më të mirë të korrupsionit, kuptim që duhet raportuar tek institucionet.

Nevojitet punë plotësuese për të përmirësuar kuptimin e konfliktit të interesit si pjesë e problemit të korrupsionit. Siç pritej, përmirësimi i njohurive është më i nevojshëm, dhe më shumë kohë është e nevojshme për të përcjellë atë koncept.

Megjithatë, hulumtimi ka demonstruar edhe një herë problemin me zhvendosjen e orientimeve të thella të vlerave. Sigurisht se, disa orë nuk mund të pritet të kontribuojnë ndjeshëm në përmirësimet në këtë

nivel, por rezultati kujton nevojën për dialog mbi vendin e arsimit në luftën kundër korrupsionit. Kjo i referohet rolit të procesit në formimin e individit (arsim), si rezultat indirekt i transferimit të njohurive (të mësuarit).

Prandaj, përveç orëve mësimore ku problemi i korrupsionit do të trajtohet drejtpërdrejt, studimi tregon se reformat në arsim duhet të përcaktojnë qëllime specifike arsimore në lidhje me ndërtimin e integritetit personal të rinjve. Sigurisht, arsimi formal është vetëm një pjesë e socializimit, por Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në reformat aktuale të arsimit fillor dhe të mesëm, duhet të krijojë kushte në të cilat kombinimi i të mësuarit dhe arsimit do të prodhojë një mjedis për përmirësimin e vlerave themelore. Vetëm në këtë mënyrë mund të presim që gjeneratat e ardhshme, përkatësisht ata që do të arsimohen tani e tutje, do të jenë aktorë aktivë dhe aleatë në luftën kundër korrupsionit.

Informacione rreth IDSCS-ë

IDSCS është t'ink tenk organizatë, që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe integrimet evropiane të Maqedonisë së Veriut. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën politike participative. Përmes forcimit të vlerat liberaliste, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve

Të dhëna për kontakt, për IDSCS

—
**Adresa: rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 / 2,
1000 Shkup**

Tel. Nr.: +389 2 3094 760,

e-mail: contact@idscs.org.mk

Informacion mbi KSHPK

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) është i pavarur në kryerjen e veprimtarive të përcaktuara me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe ka statusin e personit juridik. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit zbaton dhe fillon zbatimin e ligjeve, inkurajon forcimin normativ dhe institucional, krijon politika dhe masa anti-korrupsion, ndërmerr aktivitete që synojnë forcimin e integritetit personal dhe institucional, përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar dhe zhvillon një kulturë ligjore, dhe misioni i tij është të krijojë sistem efektiv për parandalimin dhe represionin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Informacione për kontakt për KSHPK:

—
Rr. Dame Gruev 1,

1000 Shkup,

tel. : +389 2 3215 377,

email contact@dksk.org.mk,

ueb faqja www.dksk.mk

Informacione rreth projektit

Projekti "Edukimi Antikorrupsion në Shkollat e Mesme" synon të rrisë ndërgjegjësimin tek të rinjtë për korrupsionin, të forcojë njohuritë e tyre për korrupsionin, format e korrupsionit dhe mjetet anti-korrupsion, si dhe të forcojë njohuritë e tyre për rëndësinë e ndërtimit të integritetit personal.

Projekti zbatohet nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup, së bashku me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me mbështetje financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës. Aktivitetet e projektit mbështeten nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

